



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2023
Nr. Ref.:RK 2185/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI42/22

Parashtrues

Hysni Bajraj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës,
PNS.nr.58/2021, të 8 nëntorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hysni Bajraj, me vendbanim në Gjakovë, Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqësojnë avokatët Fis Murati dhe Labinot Murati nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [PNS.nr.58/2021] e 8 nëntorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) në lidhje me Urdhrin Ndalues Afatgjatë [PNDS.nr.16/21] i 15 tetorit 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Vendimin e kontestuar e ka pranuar më 13 dhjetor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta Për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 prill 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
7. Më 19 prill 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 prill 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
9. Më 20 prill 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 12 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton që Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: PSRK), me 28 shkurt 2020, kishte pranuar rastin [NJN.nr.18/2020] e ripërtërirë me datë 6 shtator 2021, me numër referues [MD/DBGJ/4045/fn/21 e DBJN/2020-183] të parashtruar nga autoritetet zvicerane përmes Ministrisë së

Drejtësisë-Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, së bashku me shkresat tjera lidhur me kërkesën për konfiskimin përkatësisht sigurimin e të dhënave bankare, dokumentet e hapjes së llogarisë bankare, dokumentet e legjitimitetit si dhe listat e qarkullimit bankar, së bashku me dëshmitë individuale për transferet e daljes dhe dëshmitë për tërheqjen e parave të parashtruesit të kërkesës dhe A.B (i biri i parashtruesit të kërkesës).

13. Rrjedhimisht, Prokuroria e qytetit të Bazelit, përmes kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike ndërkombëtare për çështjen penale në procesin hetimor kundër: (i) A.B. i dyshuar si autor i veprës së mashtrimit profesional, të pastrimit profesional të parave, të falsifikimit të dokumenteve, të nxitjes së përsëritur të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, si dhe kundër (ii) parashtruesit të kërkesës i dyshuar si autor i veprës pastrim parash, kërkoi nga autoritetet e Republikës së Kosovës, që në kontekst të gjetjes së personave tjerë të përfshirë, por edhe për të përcaktuar fluksin e mundshëm të parave nga burime të paligjshme, të ndërmerrnin veprimet konkrete: (1) kryerjen e kontrollit të banesave [...]; (2) hetim tek institucionet bankare në Kosovë në lidhje me ekzistencën e llogarive bankare [...] në emër të parashtruesit të kërkesës dhe A.B., si dhe sekuestrimin e pasurisë së tyre.
14. Më 14 shtator 2021, PSRK lëshoi Urdhrin për ngrirje të përkohshme të pasurive dhe urdhrin për të parandaluar tërheqjen e mjeteve nga një llogari bankare [NJN.nr. 18/2020] duke bërë: (i) ngrirjen e përkohshme të aseteve respektivisht të xhirollogarive bankare për parashtruesin e kërkesës dhe A.B, që të dy të pandehur, nëpër bankat e përcaktuara komerciale, si dhe (ii) kishte bërë ngrirjen e përkohshme të aseteve, respektivisht pronave që janë në posedim të parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e këtij urdhri PSRK kishte theksuar si në vijim:

“Sekuestrimi është i domosdoshëm për të siguruar një Urdhër-Konfiskim në të ardhmen për shkak se ekziston frika se të akuzuarit do të bëjnë gjithçka që është e mundur për të parandaluar konfiskimin e pasurive nga ana e shtetit, duke marrë parasysh që ata janë të vetëdijshëm për gjëndjen faktike dhe ligjore.

Sipas rezultateve të hetimeve, A.B dhe Hysni Bajraj dyshohen për pastrim parash. Ata kanë marrë para të thata për rinovim dhe blerjen e pasurive të patundshme. Ata janë pronarë të një shtëpisë që nuk do të ishin kurrë në mundësi ta financojnë nga fondet e veta dhe ngasin një automjet aq të shtrenjtë që, për ta blerë, ata do të ishin në detyrë të kursejnë të gjitha të ardhurat e tyre nga Qershori i vitit 2018 deri në vitin 2019, pa shpenzuar një cent në shpenzimet e jetesës. Për këtë arsye duhet të sekuestrohen llogaritë në Kosovë, Asetet të cilat janë në Kosovë: llogaritë bankare eventuale të poseduesit të llogarisë së përmendur në këtë institucion bankar.

15. Më 14 shtator 2021, PSRK parashtrroi kërkesë për urdhër ndalues të aseteve me numër [NJN.nr.18/2020] pranë Gjykatës Themelore, me të cilën kërkonte lëshimin e urdhrin ndalues për xhirollogaritë bankare dhe pronat (asetet) e theksuara në këtë urdhëresë.
16. Më 15 shtator 2021, Gjykata Themelore përmes Urdhrit Ndalues për ngrirje të përkohshme të aseteve [PNDS.nr.16/2021] ndaj të dyshuarve: parashtruesit të kërkesës dhe A.B.: (i) urdhëroi ngrirjen e përkohshme të aseteve respektivisht të xhirollogarive bankare në disa banka ku përfshihen: llogaritë bankare në Raiffeisen Bank; ProCredit Bank dhe në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT); (ii) urdhëroi ngrirjen e përkohshme të aseteve, respektivisht të pronave, në posedim të parashtruesit të kërkesës ku përfshiheshin banesa në Prishtinë dhe disa parcela në Xërxë – Komuna e Rahovecit dhe në Gjakovë; [...] urdhri ndalues kishte vlefshmëri 30 ditë nga dita e lëshimit dhe atë prej datës 15 shtator 2021 deri me 15 tetor 2021; Seanca dëgjimore u caktua për 11 tetor 2021

dhe se personat e interesuar që pretendojnë të kundërshtojnë ngrirjen e kësaj pasurie duhet të marrin pjesë në shqyrtimin e caktuar [...], ku do të kenë mundësi të paraqesin argumentet e tyre lidhur me urdhrin ndalues; Ndalimi afatgjatë i kësaj pasurie mund të urdhërohet në këtë seancë dhe prek të drejtat e parashtruesit të kërkesës në këtë pasuri.

17. Më 15 tetor 2021, Gjykata Themelore përmes Urdhrit për Ndalim Afatgjatë [PNDS.nr.16/2021]: (I) aprovoi kërkesën për urdhër ndalues të aseteve [NJN.nr.18/2020] e 14 shtatorit 2021, e PSRK-së; (II) konfirmoi ndalimin afatgjatë të pasurisë së ndaluar sipas Urdhrit për ngrirje të përkohshme të aseteve [PNDS.nr.16/2021] të 15 shtatorit 2021; (III) urdhëroi ndalimin afatgjatë të aseteve (paluajtshmërive dhe llogarive bankare) në emër/posedim-të parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit A.B, asetet ku përfshiheshin: llogaritë bankare në Raiffeisen Bank, në ProCredit Bank dhe në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT); pronat e paluajtshme në posedim/pronësi të parashtruesit të kërkesës ku përfshiheshin: banesa në Prishtinë, parcelat në Xërxë-Komuna e Rahovecit dhe në Gjakovë; (IV) Ndalohet çdo transaksion bankar (duke përfshirë edhe: deponim, tërheqje, transfere, mbyllje të llogarisë, autorizim të personave tjerë në llogari, etj.) në llogaritë bankare të theksuara sikurse nën II. e III. të këtij urdhri; (V) Këtë urdhër ndalues afatgjatë në raport me llogaritë bankare do ta zbatojnë institucionet bankare në të cilat janë të hapura këto llogari, respektivisht institucionet bankare të theksuara sikurse nën II. e III. të këtij urdhri; [...] (VII) Këtë urdhër ndalues duhet ta zbatojë Oda e Noterëve e Republikës së Kosovës (Zyrat Noteriale të Republikës së Kosovës) dhe Shërbimi për Kadastër e Gjeodezi i komunave ku gjenden pasuritë e theksuara sikurse nën II. e III. të këtij urdhri; [...] (IX) Ky urdhër ndalues vlen deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pushimit të hetimit, ose si është përcaktuar në paragrafin 11 të nenit 266 KPPRK; (X) Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e këtij urdhri.
18. Në arsyetimin e këtij urdhri, Gjykata Themelore ndër të tjera arsyetoi si në vijim: *“Nga llogaritë bankare të ofruara nga mbrojtja si prova në shqyrtim për lëshimin e urdhrit ndalues afatgjatë, shihen qarkullime bankare të shumave të cilat janë deponuar dhe tërhequr nga I pandehuri Hysni Bajraj, mirëpo me asnjë fakt të vetëm apo provë të pandehuri Hysni Bajraj, nuk ka mundur ta vërtetojë se nga janë transferuar këto para në llogaritë bankare, si janë deponuar këto para në bankë dhe nga janë realizuar. Në të vërtetë gjykata ka vërtetuar dhe atë edhe nga deklarami i vet të pandehurit Hysni Bajraj, se mjetet financiare janë mjete të cilat ai i ka deponuar kohë pas kohe në llogaritë e tij përmes keshit dhe se ky kesh rrjedhë nga puna që e ka bërë në Zvicër, pa ofruar ndonjë provë konkrete.”*
19. Më 28 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës ushtron ankesë kundër Urdhrit të lartcekur, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzojë kërkesën për urdhër ndalues të aseteve [NJN.nr.18/2020] të 14 shtatorit 2021, të PSRK-së, ashtu që të urdhërohet lirimi i menjëhershëm i pasurisë/aseteve, si dhe të anulohet Urdhri për Ndalim Afatgjatë me numër [PNDS.nr.16/2021] i 15 tetorit 2021, i Gjykatës Themelore, ashtu që çështja kthehet në rivendosje pranë të njëjtës gjykatë.
20. Më 2 tetor 2021, Prokurori i Apelit të Kosovës, me parashtrësën [PPN/I.nr.345/2021] propozoi që Gjykata e Apelit të refuzojë si të pabazuara ankesën lidhur me Urdhrin Ndalues Afatgjatë [PNDS.nr.16/21] si dhe i njëjti të vërtetohet dhe të mbeten në fuqi.
21. Më 8 nëntor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PNS.nr.58/2021] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe A.B., ndërsa vërtetoi urdhrin ndalues afatgjatë [PNDS.nr.16/21] të 15 tetorit 2021, të Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e saj Gjykata e Apelit kishte theksuar si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e bëra në ankesa nuk qëndrojnë, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës ekziston dyshimi i bazuar se të dyshuarit kanë kryer veprën penale të cilën i vihet në barrë. Prandaj, nga kjo rezulton edhe dyshimi se asetet/pronat dhe llogarive bankare për të cilat është lëshuar urdhri ndalues afatgjatë ndaj të pandehurve të lartcekur, dyshohet se është përfituar me kryerjen e veprave penale, të përcaktuara sipas Legjislacionit Penal të Zvicrës dhe atë veprës penale mashtrim për dyshim tregtar, veprës penale falsifikim i dokumentit në detyrë dhe veprës penale pastrim i parasë.

Andaj bazuar në të gjitha këto fakte qëndron baza ligjore nga neni 266 të KPPK-së, për lëshimin e urdhrin për ndalim afatgjatë, dhe nuk skadon deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësorë, pushimit të hetimeve ose sipas nenit 266 par.10 e 11 të KPPK-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta Për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
23. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutë në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar ka *mungesë të arsytimit*, pasi që nuk është dhënë arsyetim i mjaftueshëm dhe adekuat përkitazi me refuzimin e ankesës të parashtruesit të kërkesës dhe lënies në fuqi të Urdhrit për Ndalim Afatgjatë të Aseteve.
24. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se duke u bazuar në nenin 266, paragrafët 1.5 si dhe paragrafin 6, nën paragrafin 6.2., të Kodit të Procedurës Penale, organ kompetent për lëshimin e urdhrin për ndalim afatgjatë të asetëve siç ka kërkuar Prokuroria Zvicerane është gjykata, ashtu që në përputhje me nenin 82, paragrafi 1, të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, kërkesa për ngrirje të asetëve është dashur që të paraqitet nga Gjykata kompetente në Zvicër dhe jo nga prokuroria siç ka ndodhur në rastin konkret.
25. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendonte që kërkesa për bashkëpunim ndërkombëtar e parashtruar nga Prokuroria e Bazelit nuk ishte përpiluar dhe parashtruar në konformitet me nenin 83, paragrafi 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështje Penale, duke theksuar se në rastin konkret kërkesa e autoriteteve zvicerane nuk përmbante informacione se kur pretendohet të jetë kryer vepra penale, (koha e kryerjes së veprës penale); si dhe kërkesa nuk përmbante ndonjë informacion se cili është afati i parashkrimit për veprat penale për të cilat ishin në procedurë hetimore në Zvicër.
26. Për sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson që mos trajtimi i pretendimeve ankimore si dhe mos dhënia e përgjigjeve të sakta dhe të qarta lidhur me pretendimet ankimore, e shkelin nenin 32 të Kushtetutës [E Drejta për Mjete Juridike], pasi që e drejta për mjete juridike nuk nënkupton vetëm paraqitjen e ankesës në kuptimin procedural, por nënkupton trajtimin e ankesës në aspektin material nga ana e organit i cili ka kompetencë për ta shqyrtuar dhe vendosur, në atë kuptim që organi kompetent të shqyrtoj pretendimet e paraqitura në ankesë dhe i cili vendos lidhur me ankesën, për të njëjtat pretendime ka obligim ligjor dhe kushtetues të jap arsyetim dhe përgjigje se pretendimet a janë apo jo të qëndrueshme/paqëndrueshme, dhe nëse po, për çfarë arsye.

27. Rrjedhimisht, duke i ndërlidhur shkeljet e pretenduara të nenit 32 të Kushtetutës me *vendimin e arsyetuar gjyqësor*, parashtruesi përsërit që Gjykata e Apelit ka dështuar të japë arsyetim lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 82, paragrafi 1, të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, në lidhje me nenin 266, paragrafët 1 dhe 5, si dhe paragrafin 6, nën paragrafin 6.2 të Kodit të Procedurës Penale.
28. Parashtruesi i kërkesë gjithashtu thekson se gjykatat e rregullta në arsyetimin e tyre për vendosjen e urdhrin për ndalim afatgjatë të aseteve nuk e kishin elaboruar se në bazë të cilave prova është konstatuar se ka kryer vepër penale me të cilën ngarkohet dhe se pasuria e tij është krijuar me vepër penale. Ai poashtu thekson se nuk ka obligim ligjor që të prezantojë prova të mjaftueshme për të argumentuar pasurinë e tij si dhe të arsyetojë lëvizjen e mjeteve monetare nëpër xhironlogari. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit, në këtë rast barra e të provuarit është bartur nga Prokurori tek i pandehuri – parashtruesi i kërkesës.
29. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se mosdhënia e përgjigjeve dhe sqarimeve nga ana e gjykatave të rregullta ka cenuar edhe *parimin e kontradiktoritetit* dhe *parimin e barazisë së armëve*, pasi që nuk ishte njoftuar parashtruesi i kërkesës se cilat janë ato prova të cilat i ka në dispozicion prokuroria dhe gjykata, në mënyrë që i pandehuri të ketë mundësinë e kundërshtimit të këtyre provave. Për më tepër parashtruesi i kërkesës thekson që Gjykata e Apelit nuk ka dhënë asnjë sqarim dhe përgjigje në lidhje me refuzimin e propozimit të mbrojtjes nga shkalla e parë që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohej informatori i përmendur në kërkesën e autoriteteve Zvicerane, ashtu që për shkak të këtij refuzimi mbrojtja në ankesë kishte pretenduar se është shkelur rëndë parimi i barazisë së armëve. Gjithashtu, i njëjti pretendon se Gjykata e Apelit nuk i kishte dhënë përgjigje lidhur me provat e dorëzuara përmes “Parashtresës për dorëzimin e provave plotësuese të 21 nëntorit 2021, rrjedhimisht i është cenuar parimi i barazisë së armëve.”
30. Lidhur me aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës citon edhe rastin e Gjykatës KI75/21, me parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*Energy Development Group Kosova LLC*”, “*Alsi & Co. Kosove LLC*” dhe “*Building Construction LLC*”, ku thekson se Gjykatat duhet të japin përgjigje specifike dhe të qarta lidhur me pretendimet thelbësore të palës, ato që janë vendimtare për rezultatin e procedurës dhe pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
31. Parashtruesi i kërkesës në vijim ka pretendime edhe për sa i përket “*standardeve të dyfishta të vlerësimit të provave*” nga ana e gjykatave të rregullta, pasi që të njëjtat kishte trajtuar dhe aprovuar me lehtësi pretendimet e ngritura nga prokuroria ndërsa arsyetimet e dhëna nga parashtruesi për krijimin e ligjshëm të pasurisë së tij, ai pretendonte që gjykatat kanë konstatuar se “kjo çështje duhet të verifikohet gjatë hetimit se si janë krijuar këto pasuri.”
32. Gjithashtu si shkelje tjetër të bërë përmes vendimit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës thekson se Urdhri Ndalues Afatgjatë për ngrirjen e aseteve është lëshuar nga Gjykata Themelore pas kalimit të afatit 30 ditor, pra në ditën e 31, ndërsa Gjykata e apelit nuk e ka sqaruar fare këtë çështje.
33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konsideron që privimi i tij nga shfrytëzimi i pasurisë së tij nënkupton shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, pasi që ai pretendon që pronësia mund të kufizohet vetëm përmes një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm, çka nuk ishte rasti në rrethanat e rastit konkret.
34. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e tij të aprovohet e pranueshme, dhe të konstatohet se ka pasur (II) shkelje të nenit 31 [E Drejta për

Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së; III. Të shpallen të pavlefshëm, Aktvendimi [PNS.nr.58/2021] i 8 nëntorit 2021, i Gjykatës së Apelit; Urdhri për Ndalim Afatgjatë të Aseteve [PNDS.nr.16/2021] i 15 tetorit 2021, i Gjykatës Themelore; (IV) të kthehet për rishqyrtim Urdhri për Ndalim Afatgjatë të Aseteve [PNDS.nr.16/2021] i 15 tetorit 2021, i Gjykatës Themelore, konform Aktgjykimit të kësaj gjykate.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*
- 6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
- 7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.*

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës*

nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

LIGJI NR. 04/L-213 PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE

Neni 82

Autoriteti që parashtron kërkesë për ndihmë juridike

1. Gjatë procedurës paraprake deri në ngritjen e aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë paraqitet nga prokurori i shtetit i cili udhëheq procedurën për të cilën kërkohet ndihmë. Në rastet kur veprimi apo masa që kërkohet të ndërmerret po të ishte ndërmarrë në Republikën e Kosovës në bazë të Kodit të Procedurës Penale do të kërkonte një urdhër nga gjykata, atëherë kërkesa duhet të parashtrohet nga gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit.

2. Pas ngritjes së aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike duhet të paraqitet nga gjykata që zhvillon procedurën për të cilën kërkohet ndihmë.

3. Kërkesa për ndihmë juridike i dorëzohet Ministrisë e cila e shqyrton dhe transmeton atë së bashku me çdo dokument tjetër mbështetës tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

Neni 83

Përmbajtja e Kërkesës

1. Kërkesa për ndihmë bëhet me shkrim dhe përfshin informatat e mëposhtme:

[...]

1.3. ekstraktin e dispozitave ligjore të zbatueshme, duke përfshirë dispozitat për parashkrimin dhe dënimin që mund të shqiptohet;

[...]

Neni 90

Kontrollimi, ngrirja dhe konfiskimi

1. Kërkesa për kontrollim, ngrirje dhe konfiskim të pasurisë duhet t'i plotësoj kushtet në vijim:

1.1. vepra që ka shkaktuar paraqitjen e kërkesës të jetë e dënueshme në bazë të ligjit të shtetit kërkues dhe ligjit vendor; dhe

1.2. ekzekutimi i kërkesës është konsistent me ligjin vendor.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 264

Ngrirja e përkohshme e aseteve

1. Nëse hetimi është autorizuar për veprë penale nga neni 90 i këtij Kodi, prokurori i shtetit mund të lëshojë urdhër për ndalimin e shitjes, shkëmbimit të pronësisë ose tërheqjen nga llogaria të cilitdo send të përshkruar në paragrafin 2 ose 3. të këtij neni.

2. Çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim të bazuar se:

2.1. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është përdorur në veprën penale nën hetim;

2.2. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është provë e veprës penale nën hetim; ose

2.3. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është fituar nga vepra penale nën hetim.

3. Çfarëdo llogarie financiare që i takon të pandehurit nën hetim, në të cilën mund të ketë mjete të cilat janë:

3.1. të ardhura nga vepra penale nën hetim; ose 3.2. përdorur në kryerjen e vazhdueshme të veprës penale nën hetim.

[...]

Neni 266

Shqyrtimi për konfirmimin e ndalimit të pasurisë

1. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të marrë parasysh provat apo dëshmitarët në mbështetje të urdhrin ndalues të lëshuar më parë gjatë çmuarjes nëse duhet lëshuar urdhër për ndalim afatgjatë në përfundim të shqyrtimit për ndalim. Ai poashtu mbështet urdhrin për ndalim afatgjatë në provat e paraqitura gjatë shqyrtimit për ndalim nga paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni.

2. Prokurori i shtetit paraqet prova ose dëshmitarë në mbështetje të urdhrin ndalues.

3. I pandehuri mund të paraqet prova ose dëshmitarë për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhrin ndalues, ose mund të paraqesë argumente kundër bazës ligjore për urdhrin ndalues.

4. Palët tjera që kanë të drejta në pasuri paraqesin prova ose dëshmitarë për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhrin ndalues, ose mund të paraqesin argumente kundër bazës ligjore për urdhrin ndalues.

5. Gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër për ndalim afatgjatë për secilin aset që kërkohet nëse ka prova të artikulueshme që tregojnë shkak të bazuar për të arsyetuar urdhrin.

6. Në përfundim të shqyrtimit, gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër, me të cilin:

6.1. refuzon ndalimin e pasurisë dhe lëshon urdhër për lirimin e menjëhershëm të pasurisë; ose

6.2. konfirmon ndalimin e pasurisë dhe menjëherë lëshon urdhër për ndalim afatgjatë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

37. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

[...]

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

38. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PNS.nr.58/2021] e 8 nëntorit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) parasheh:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

40. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26 shih gjithashtu rastin KI175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”* (shih më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284 shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
42. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
43. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjell në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës që gjykatat e rregullta nuk i kanë respektuar garancitë kushtetuese të *vendimit të arsyetuar gjyqësor*, pasi që të njëjtat nuk i janë përgjigjur pretendimeve esenciale të parashtruesit të kërkesës lidhur me çështjet vijuese: (i) kërkesa për ngrirje të aseteve është dashur të paraqitej nga Gjykata kompetente në Zvicër, e jo nga Prokuroria siç ka ndodhur në rastin konkret dhe se e njëjta nuk përmban informacione se kur pretendohet të jetë kryer vepra penale, përkatësisht cili është afati i parashkrimit për

veprat penale për të cilat ishin në procedurë hetimore në Zvicër;(ii) standardi ligjor për lëshimin e urdhrit për ndalim afatgjatë të aseteve duhet të përkoj me *dyshimin e bazuar*; (iii) nuk kishte asnjë provë të vetme përmes të cilës argumentohet që pasuria e parashtruesit të kërkesës është produkt i ndonjë vepre penale; (iv) nuk është arsyetuar refuzimi i propozimit të mbrojtjes për të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit *informatori* i përmendur nga autoritetet zvicerane.

44. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar (I) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës [E Drejta për Mjete Juridike] si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, si dhe (II) pretendimet përkitazi me shkeljet e nenit 46 të Kushtetutës si rezultat i privimit të kundërligjshëm nga asetet dhe pasuria e tij.

(I) Sa i përket pretendimit për shkelje të neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar

i. Parimet e përgjithshme

45. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), nr.12945/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 20124/92, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; [Pronina kundër Ukrainës](#), nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe [KI24/17](#), parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
46. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, cituar më lartë, paragrafi 44).
47. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit

konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNj-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lartë, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lartë, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, cituar më lartë, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë (Nr.2)*, nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

48. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: *KI72/12, Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. *KI135/14*, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe *KI96/16, IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; KI138/19 parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, cituar më lartë, paragrafi 138).

ii. *Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

49. Në këtë kontest, Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlihdet me çështjen që (i) kërkesa për ngrirje të aseteve është dashur të paraqitet nga Gjykata kompetente në Zvicër, e jo nga Prokuroria siç ka ndodhur në rastin konkret dhe se e njëjta nuk përmban informacione se kur pretendohet të jetë kryer vepra penale, përkatësisht cili është afati i parashkrimit për veprat penale për të cilat ish-in në procedurë hetimore në Zvicër; (ii) standardi ligjor për lëshimin e urdhrit për ndalim afatgjatë të aseteve duhet të përkojë me *dyshimin e bazuar*; (iii) nuk kishte asnjë provë të vetme përmes të cilës argumentohet që pasuria e parashtruesit të kërkesës është produkt i ndonjë vepre penale; (iv) nuk është arsyetuar refuzimi i propozimit të mbrojtjes për të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit *informatori* i përmendur nga autoritetet zvicerane.
50. Në ndërlihdje me çështjet e lartcekura, Gjykata në vazhdim do t'u referohet pjesëve relevante të vendimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesve të kërkesës. Fillimisht, Gjykata i referohet Urdhrit për Ndalim Afatgjatë [PNDS.nr.16/2021] të Gjykatës Themelore, e cila pretendimin e parashtruesit që për lëshimin e Urdhrit për ndalim afatgjatë duhet të ekzistojë standardi i *dyshimit të bazuar*, ka arsyetuar si në vijim:

“Në rastin konkret ekziston dyshimi se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen, ku këtë dyshim gjykata e ka konstatuar nga shkrësat - provat e pranuar nga autoritetet Zvicerane, e të cilat prova vërtetojnë se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se në rastin konkret duhet të ekzistoj dyshimi i bazuar si standard ligjor për lëshimin e urdhrin ndalues, gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret ekziston standardi i dyshimit si kusht i kërkuar ligjor dhe atë i vërtetuar me provat e faktet

të cilat i janë vënë në dispozicion përmes ndihmës juridike ndërkombëtare nga autoritetet Zvicerane.

Neni 266 i KPPRK, respektivisht paragrafi 5 i po këtij neni kërkon si standard ligjor shkaku e bazuar, e që shkaku i bazuar si standard ligjor nuk përkon me pretendimin e mbrojtjes se në këtë rast duhet të kemi dyshimin e bazuar edhe pse gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen, ku ky dyshim është konstituuar nga provat e siguruara përmes rrugës juridike ndërkombëtare nga autoritetet Zvicerane.”

51. Në vijim, për sa i përket pretendimit se nuk kishte asnjë provë të vetme përmes të cilës argumentohet që pasuria e parashtruesit të kërkesës është produkt i ndonjë vepre penale, Gjykata Themelore kishte arsyetuar si në vijim:

“Nga llogaritë bankare të ofruara nga mbrojtja si prova në shqyrtim për lëshimin e urdhrin ndalues afatgjatë, shihen qarkullime bankare të shumave të cilat janë deponuar dhe tërhequr nga i pandehuri Hysni Bajraj, mirëpo me asnjë fakt të vetëm apo provë i pandehuri Hysni Bajraj, nuk ka mundur ta vërtetojë se nga janë transferuar këto para në llogaritë bankare, si janë deponuar këto para në bankë dhe nga janë realizuar. Në të vërtetë gjykata ka vërtetuar dhe atë edhe nga deklarimi i vet të pandehurit Hysni Bajraj, se mjetet financiare janë mjete të cilat ai i ka deponuar kohë pas kohe në llogaritë e tij përmes keshit dhe se ky kesh rrjedhë nga puna që e ka bërë në Zvicër, pa ofruar ndonjë provë konkrete.

Gjykata, nga raportet e llogarive bankare ka vërejtur se Hysni Bajraj, ka deponuar mjete të konsiderueshme financiare në llogaritë e tij bankare, ka bërë lëvizje të mjeteve financiare dhe atë të shumave edhe mbi 100.000 EURO, mirëpo në asnjë rast nuk ka ofruar asnjë provë se këto mjete janë krijuar nga aktivitete të ligjshme, ndërsa në të kundërtën autoritetet Zvicerane kanë ofruar prova të mjaftueshme se ekziston dyshimi se këto mjete financiare janë krijuar nga A.B., e pastaj janë investuar në Kosovë nga babai i tij Hysni Bajraj.”

52. Në vijim, për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës që kërkesa për ngrirje të asetëve konform Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Çështje Penale është dashur të paraqitet nga Gjykata kompetente në Zvicër, e jo nga Prokuroria dhe se kërkesa nuk përmban informacione se kur pretendohet të jetë kryer vepra penale, përkatësisht cili është afati i parashkrimit për veprat penale për të cilat ish-in në procedurë hetimore në Zvicër, Gjykata Themelore e arsyetoi si në vijim:

“Po ashtu sa i përket pretendimit të mbrojtjes se kërkesa është në kundërshtim me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, konsideron se kërkesa është e parashtruar përmes rrugëve diplomatike dhe se kjo kërkesë i ka përmbushur të gjitha kushtet ligjore që të trajtohet nga gjykata dhe e njëjta të mos refuzohet si e pa lejuar.”

53. Gjykata gjithashtu vëren se për sa i përket pretendimit të mos arsyetimit se pse i është refuzuar propozimi i mbrojtjes për të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit *informatoren* e përmendur nga autoritet zvicerane, Gjykata Themelore kishte arsyetuar si në vijim:

“Gjykata sa i përket propozimit të mbrojtjes dhe të pandehurve që të dëgjohet informatori i cili i ka ofruar informata organeve të ndjekjes penale të Zvicrës, ka refuzuar propozimin për dëgjimin e këtij informatori për faktin se informatoret janë të mbrojtur dhe se hetimet janë në faza fillestare dhe çdo dëgjim i këtij informatori do ta dëmtonte hetimin.”

54. Gjykata më tutje i referohet Aktvendimit [PNS.nr.58/2021] të 8 nëntorit 2021, të Gjykatës së Apelit, e cila pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës i arsyetoi si në vijim:

“Prandaj, kjo Gjykate vlerëson se, tani për tani ekzistojnë arsyet ligjore për lëshimin e urdhrin për ndalim afatgjate, dhe se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka lëshuar urdhrin ndalues afatgjatë, meqë Prokurori Speciale e Kosovës, ka ofruar prova të artikulueshme që tregojnë shkak të bazuar që arsyetojnë urdhrin ndalues, meqë se ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit e lartcekur kanë kryer veprat penale, ku këtë dyshim gjykata e ka konstaton nga shkresat-provat e pranuar nga autoritetet Zvicerane, e te cilat prova vërtetojnë se te pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen. Gjithashtu asetet-pronat e ndaluara me këtë urdhër, lidhur me to ekziston dyshimi se të njëjtat janë krijuar si rezultat i veprave penale, duke u bazuar ne provat e autoriteteve zvicerane, dhe se të njëjtit te akuzuar me ato mjete financiare kanë krijuar këto asete-prona. Gjykata nga raportet e llogarive bankare ka vërejtur se njëri nga të pandehurit, ka deponuar shuma të mëdha të parave, dhe ka bërë lëvizje të mjeteve financiare ku lidhur me to nuk ka dhënë asnjë provë se këto mjete janë krijuar nga aktivitete të ligjshme, ndërsa në të kundërtën autoritetet zvicerane kanë ofruar prova të mjaftueshme se ekziston dyshimi se këto mjete financiare janë mjete të cilat janë krijuar nga djali i të pandehurit e pastaj janë investuar në Kosovë nga i pandehuri tjetër.

Gjykata ka marrë parasysht edhe disa pretendimin tjera mirëpo për gjykatën tani nuk ka dëshmi për pretendimet e paraqitura e po ashtu marrë parasysht se çështja është në fazë të hetimeve gjykata gjen se është i domosdoshëm tani për tani që të lëshohet ky urdhër ndalues afatgjatë dhe se gjatë fazës së hetimeve para ngritjes së akuzës ose edhe më vonë dyshuarit mund të dëshmojnë me prova materiale deklarimin e tyre. Andaj për këto shkaqe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate urdhri për ndalim afatgjatë rezulton të jetë i mbështetur në prova të pranueshme dhe të bazuara në ligj.”

55. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve relevante të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes ankesës kundër Urdhrin për Ndalim Afatgjatë të aseteve, me ç’ rast ka vlerësuar se gjykatat kanë pasur prova të mjaftueshme dhe bindëse që mbështesin konkluzionin e tyre përkitazi me vendimmarrjen në çështjen e parashtruesit të kërkesës.
56. Gjykata, dëshiron të rikujtojë gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lartë; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lartë, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, nr. 40490/98, Vendim i 29 gushtit 2000, paragrafi 81).
57. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlihen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që

argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI128/19, parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për Papranueshmëri i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).

58. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesve të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kërkesës edhe me tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjyimit të çështjes së tij, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
59. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, të ndërlidhura nga parashtruesi i kërkesës edhe me nenin 32 të Kushtetutës, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(II) Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
61. Në ndërlidhje me pretendimin e shkeljes të së drejtës së Pronës, Gjykata i referohet edhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, Neni 1 i Protokollit nr. 1 përmban tre rregulla të dallueshme. Rregulli i parë, i përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është i një natyre të përgjithshme dhe shpreh parimin e *gëzimit paqësor të pronës*. Rregulli i dytë, i përfshirë në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon vetëm *privimin nga "posedimet"* dhe e nënshtron atë në disa kushte. Rregulli i tretë, i deklaruar në paragrafin e dytë, njeh se Shtetet Kontraktuese kanë të drejtë, ndër të tjera, të *kontrollojnë përdorimin e pronës* në përputhje me interesin e përgjithshëm. (shih rastet e GJEDNJ-së: [Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë](#), nr. 7151/75; 7152/75, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 61; [Iatridis kundër Greqisë](#), nr. 31107/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999, paragrafi 55; [J.A. Pye \(Oxford\) Ltd dhe J.A. Pye \(Oxford\) Land Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 44302/02, Aktgjykim i 30 gushtit 2007, paragrafi 52; [Ališić dhe të tjerët kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), nr. 60642/08, Aktgjykim i 16 korrikut 2014, paragrafi 98).
62. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës, sikundër edhe neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih rastet e Gjykatës: [KI201/18](#), me parashtrues *Selami Taraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 nëntorit 2019, paragrafi 39; [KI83/18](#), me parashtrues *Ivica Milosevic*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 tetorit 2019, paragrafi 41; Shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: [Van der Mussele kundër Belgjikës](#), nr. 8919/80, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe [Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë](#), kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
63. Në këtë kuadër, Gjykata i referohet interpretimeve të GJEDNJ, ku vihet në pah se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ-së vlen vetëm për "*zotërimet*"

ekzistuese të një personi (shih rastet e GJEDNJ-së: [Marckx kundër Belgjikës](#), nr. 6833/74, Aktgjykim i 13 qershorit 1979, paragrafi 50; [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, paragrafi 64).

64. Konfiskimi dhe ngrirja e aseteve përgjithësisht konsiderohen nga GJEDNJ si kontroll i përdorimit të pronës, i cili duhet të konsiderohet sipas paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pavarësisht faktit që përfshijnë privim nga "posedimet" (shih rastet e GJEDNJ-së: [AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9188, Aktgjykim i 24 tetorit 1986, paragrafi 51; [Raimondo kundër Italisë](#), nr. 12954/87, Aktgjykim i 22 shkurtit 1994, paragrafi 29; [Imeri kundër Kroacisë](#), nr. 77668/14, Aktgjykim i 24 shtatorit 2021, paragrafi 66). Për sa i përket çështjes se cila prej rregullave të nenit 1 të Protokollit nr. 1 zbatohet, GJEDNJ e rithekson qëndrimin e saj konsistent që masa e konfiskimit si dhe ngrirjet e aseteve, konsiderohen kontrollim i përdorimit të pronës, në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.
65. Rrjedhimisht, Gjykata së pari do të trajtojë, nëse parashtruesi i kërkesës ka pasur "pronë" sipas nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

A. A ka pasur parashtruesi i kërkesës pronë

66. Duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, për sa i përket çështjes se *a zbatohet* neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së, Gjykata vlerëson se urdhri për ndalim afatgjatë të aseteve, përkundër që përfshin privim të posedimeve, megjithatë përbën kontroll të përdorimit të pronës sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.
67. Duke ju referuar praktikës së sipërpërmendur, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës, gëzon "pronë" në kuptimin e nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
68. Në këtë drejtim, Gjykata më tutje do të shqyrtojë se a ka pasur ndërhyrje në të drejtën e pronës së parashtruesit të kërkesës.

B. A ka pasur ndërhyrje

69. Gjykata fillimisht thekson se praktika e GJEDNJ-së thekson se një person në posedim të një sendi duhet të supozohet se ka një të drejtë pronësore mbi të derisa të krijohet prova për të kundërtën (shih rastin e GJEDNJ-së: [Imeri kundër Kroacisë](#), cituar më lartë, paragrafi 63).
70. Gjykata sjell në vëmendje që përmes Urdhrit për Ndalim Afatgjatë [PNDS.nr.16/2021] të 15 tetor 2021, të Gjykatës Themelore, i cili u konfirmua më 8 nëntor 2021, përmes Aktvendimit [PNS.nr.58/2021] të Gjykatës së Apelit, ndër të tjera u urdhërua ndalimi afatgjatë i aseteve (paluajtshmërive dhe llogarive bankare) në emër/posedim-të parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit A.B, asetet ku përfshiheshin: llogaritë bankare në Raiffeisen Bank, në ProCredit Bank dhe në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT); pronat e paluajtshme në posedim/pronësi të parashtruesit të kërkesës ku përfshiheshin: banesa në Prishtinë, parcelat në Xërxë-Komuna e Rahovecit dhe në Gjakovë.
71. Në rrethanat e rastit konkret Gjykata sqaron se nuk është kontestuese se urdhri për ndalim afatgjatë të aseteve përbën një ndërhyrje në të drejtën e pronësisë së parashtruesit të kërkesës.

72. Në dritën e kësaj të fundit, dhe duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës për interferim në të drejtën e tij pronësore, Gjykata do shqyrtojë se a ka pasur ndërhyrje në të drejtën e pronësore të parashtruesit e cila mund të arsyetohet.

C. Arsyetimi i ndërhyrjes në të drejtën pronësore

73. Në vijim, për sa i përket ligjshmërisë së ndërhyrjes (interferimit), Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse ka bazë ligjore në sistemin juridik të vendit për sa i përket ndalimit afatgjatë të sendeve. Në ndërlidhje me këtë të fundit, Gjykata sjell në vëmendje se Urdhri për ndalim afatgjatë të aseteve kishte bazë ligjore në nenin 266 të KPPK-së dhe se e njëjta bazë ishte përdorur në procedurat gjyqësore për sa i përket Urdhrit për Ndalim Afatgjatë [PNDS.nr.16/2021] të 15 tetor 2021, të Gjykatës Themelore, i cili u konfirmua më 8 nëntor 2021, përmes Aktvendimit [PNS.nr.58/2021] të Gjykatës së Apelit.
74. Gjykata vëren se shteti ka një interes legjitim dhe gjithashtu një detyrë, në bazë të traktateve të ndryshme ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm, që të zbatojnë masa për të zbuluar dhe monitoruar lëvizjen e parave të gatshme përtej kufijve të shteteve, pasi sasi të mëdha parash mund të përdoren për pastrim parash, dyshim ky i ngritur ndaj parashtruesit të kërkesës nga Prokuroria e qytetit të Bazelit përmes kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike ndërkombëtare për çështjen penale në proces hetimor.
75. Prandaj, çështja e mbetur për Gjykatën për të përcaktuar është nëse kishte një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura nga autoritetet për të arritur këtë qëllim dhe mbrojtjes së të drejtës së ankuesit për gëzimin paqësor të pronave të tij.

D. Proporcionaliteti i interferimit (ndërhyrjes) në të drejtën e pronës

76. Gjykata sqaron se për të qenë proporcionale, ashpërsia e ndërhyrjes duhet të jetë në përpjesëtim me seriozitetin e shkeljeve për të cilat ato janë vendosur (shih rastin e GJEDNJ-së: [Gabrić kundër Kroacisë](#), nr. 9702/04, Aktgjykim i 5 shkurtit 2009, paragrafi 39; dhe [Boljević kundër Kroacisë](#), nr. 43492/11, Aktgjykim i 31 janarit 2017, paragrafi 44).
77. Gjykata sqaron se bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, masat parandaluese të ndalimit afatgjatë të aseteve, të vendosura në mungesë të një dënimi penal, si të tilla, nuk përbëjnë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës të ndërlidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Funksionimi i supozimit se pasuria e një personi të dyshuar se i përket një aktiviteti të pastrimit të parave përfaqëson të ardhura nga aktivitetet e paligjshme nuk është e ndaluar në vetvete, nëse procedurat përkatëse i japin pronarit apo parashtruesit të kërkesës një mundësi të arsyeshme për t'ia paraqitur çështjen e tij/saj autoriteteve gjyqësore (në ndërlidhje me këtë standard, shih vendimin e GJEDNJ-së: [Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë](#), nr. 52024/99, vendim i 5 korrikut 2001).
78. Duke qenë kështu, duke pasur parasysh kufirin/margjinën e vlerësimit që gëzojnë shtetet kur kontrollojnë përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, veçanërisht në kontekstin e një politike të krijuar për të luftuar krimin e pastrimit të parave, Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gëzimin paqësor të pronave të tij nuk ishte në disproporcion me qëllimin legjitim të ndjekur. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

79. Në fund, Gjykata konkludon që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse pretendimet për (I) *vendim të paarsyetuar gjyqësor*, si dhe (II) për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, deklarohen si pretendime qartazi të pabazuara. Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 12 prill 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka Nimani